

## Raport

### Mbi shqyrtimin publik të realizuar me rastin e propozimit të Programit të rregullimit hapësinor për vitin 2020

Përfundimi nr: : 01-031/19-8684 prej më 12.02.2019, kryetari i Komunës së Tuzit, në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale dhe Vendimet mbi pjesëmarrjen e popullsisë lokale në kryerjen e punëve ka përcaktuar Projektin e Programit mbi gjendjen e rregullimit hapësinor të Komunës së Tuzit me Programin e shqyrtimit publik, i cili u është dorëzuar këshilltarëve të Komunës së Tuzit.

Projekti i Vendimit mbi rregullimin e komunikacionit në rrugët e Komunës së Tuzit ka hedhur në shqyrtim publik me kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke filluar prej më 12.12.2019, me përfundim më 26.12.2019.

Sipas programit të caktuar, është mbajtur shqyrtimi qendror publik në hapësirat e Kuvendit të Komunës së Tuzit, më 23.12.2019, me fillim në ora 10.

Shqyrtimin publik në formë elektronike, të shkruar dhe gojore e ka realizuar Kuvendi i Komunës së Tuzit. Gjatë shqyrtimit publik, qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë u është dhënë mundësia e të shprehurit me gojë, me shkrim dhe elektronikisht.

Përfaqësues i hartuesit ka qenë z.Lekë Ivezaj, sekretar i Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale i cili ka bërë edhe prezentimin hyrës mbi Projektin e Programit në fjalë.

Është sqaruar se Projekti i Programit të rregullimit hapësinor të Komunës së Tuzit për vitin 2020, është hartuar sipas nenit 244 të Ligjit mbi planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 64/17, 44/18, 63/18 i 11/19), nenit 16 të Ligjit mbi rregullimin hapësinor dhe ndërtimit të objekteve ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 51/08, 40/10, 34/11, 40/11, 47/11, 35/13, 39/13 i 33/14), nenit 38 paragrafit 1 pikës 6 të Ligjit mbi administratën lokale ("Fleta Zyrtare e RMZ", nr.2/18) dhe nenit 53 paragrafit 1 pikës 6 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e RMZ-dispozitat komunale", nr 24/19)

#### **Diskutimet e pjesëmarrësve në shqyrtimin publik:**

**Sulo Beqaj:** ka bërë më shumë se një pyetje lidhur me planifikimin e rikonstruksionit të rrugës nga shitorja deri pranë xhamisë në vendbanimin Dinoshë, konkretisht nëse me projektin kryesor të rrugës së planifikuar është paraparë kanalizimi atmosferik nën rrugë, edhe nëse mund të parashihet zgjerimi i rrugës në mënyrë që pronarëve tu merret nga pak truall, si dhe nëse mund të ndryshohet Projekti kryesor nëse tregohet nevoja për këtë.

**Anton Lulgjuraj:** ka pyetur se mbi ç 'bazë kryesisht përcaktohet çmimi i Projektit Kryesor.

**Përgjigje:**

Përgjigjet i ka dhënë sekretari i Sekretariatit për planifikim dhe rregullim hapësinor dhe punë komunale z.Lekë Ivezaj i cili ka thënë se Projekti kryesor i rrugës së planifikuar e parasheh kanalizimin atmosferik me puseta, gjithashtu mund të parashihet zgjerimi i rrugës por më parë duhet bërë shpronësimi i truallit nga ana e organeve përkatëse, e që gjithashtu nëse ka nevojë, mund të ndryshohet Projekti kryesor por me pelqimin e investitorit, zbatuesit të punëve dhe organit mbikëqyrës.

Çmimi për projektin kryesor përcaktohet përcaktohet në bazë të shumë kriterëve, ashtu siç e parasheh Rregullorja mbi çmimet minimale të dokumentacionit projektues planor, revizionin dhe kontrollin teknik dhe ofertat, i cili është sjellë nga ana e Kuvendit të Dhomës së Izhenjerve të Malit të Zi, si dhe në bazë të ofertës më të volitshme të ekzekutuesit të punëve e cila realizohet në bazë të dokumentacionit të tenderit në pajtim me Ligjin mbi prokurimet publike.

Raportin e pergaditi  
Sekretariati për planifikim, rregullim hapësinor dhe  
punë komunale



*[Handwritten signature]*